


Dhuna ndaj Grave në Shqipëri: Në krahasim me Bashkimin Evropian






Empowered lives.
Resilient nations.

PËRMBLEDHJE STUDIMI¹

Dhuna ndaj Grave në Shqipëri: Në krahasim me Bashkimin Evropian

Korrik 2019

1. Ky vërtetim u krye nga INSTAT, me ekspertizën teknike të ofruar dhe shkrimin e raportit të kryesuar nga Dr. Robin Haarr, konsulente ndërkombëtare, me mbështetjen e UNDP-së dhe UN Women dhe me ndihmën financiare të Qeverisë së Australisë, në kuadër të projektit rajonal për statistikat gjinore dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm “Të bëjmë çdo grua dhe vajzë të ketë rëndësi”, dhe të Qeverisë Suedeze, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri”. Opinione dhe mendimet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e UNDP-së, UN Women dhe/ose të donatorëve të tyre.



HYRJE

Dhuna ndaj Grave (DhNG) është një shkelje e përhapur e të drejtave të njeriut dhe një problem global i shëndetit publik me përmasa epidemike. DhNG-ja pranohet edhe si shkak edhe si pasojë e pabarazisë gjinore dhe është një pengesë kryesore që gratë dhe vajzat të gëzojnë të drejtat e njeriut dhe që ato të marrin plotësisht pjesë në shoqëri dhe ekonomi.

Nuk ka një faktor të vetëm që shkakton DhNG-në; përkundrazi, ka disa elementë që veprojnë në nivele të ndryshme të “ekologjisë sociale”, të cilët përjetësojnë dhe përforcojnë qëndrimet, normat dhe praktikat diskriminuese dhe paragjyquese gjinore, të cilat kontribuojnë në pabarazinë e përhapur të pushtetit mes burrave dhe grave në shoqëri dhe në DhNG.

DhNG-ja shfaqet në forma të ndryshme të dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike, e cila ndodh në hapësira publike dhe private. DhNG-ja shkatërron shëndetin mendor dhe fizik si edhe mirëqenien e grave e vajzave dhe mund të ketë një efekt negativ në sigurinë, stabilitetin dhe paqen e tyre afatgjatë. DhNG-ja ka gjithashtu ndikim serioz në zhvillimin dhe avancimin e grave si edhe në kontributin që ato japin në ekonomi.

DhNG-ja nuk është një fenomen i ri në Shqipëri. Ajo i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale të cilat i kanë dhënë formë Shqipërisë prej kohësh, përfshirë identitetet dhe rolet e ngurta gjinore, autoritetin patriarkal, respektimin e sistemit të nderit dhe turpit,

zakonet e urdhrave hierarkike brenda familjes si edhe kontrollin midis brezave në familje.

Me asistencën teknike dhe mbështetjen e UNDP-së dhe UNICEF-it, INSTAT kreu Vrojtimin e parë Kombëtar për Dhunën në Familje (VKDhF) në vitin 2007. Në vitin 2013, me asistencë teknike nga UNDP Shqipëri dhe mbështetje financiare nga Qeveria Suedeze, INSTAT kreu VKDhF-në e 2-të. Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave i vitit 2018 (VKDhNGV) përdori një metodologji dhe instrumente të mbledhjes së të dhënave të ngjashme me VKDhF-në e vitit 2013 për të mbledhur të dhëna të besueshme për natyrën dhe përhapjen e dhunës nga partneri intim, dhe u zgjerua më tej për të mbledhur të dhëna mbi dhunën gjatë marrëdhënies dashurore, dhunën nga jopartneri, ngacmimin seksual, përndjekjen dhe normat shoqërore që lidhen me DhNG-në. Është e rëndësishme që të monitorohet përhapja e DhNG-së në Shqipëri. Të dhënat mbi DhNG-në i ndihmojnë ata që janë përgjegjës për vendimmarrjen dhe për hartimin e politikave të kuptojnë modelet dhe tendencat me kalimin e kohës si dhe ndikimin e iniciativave të NDhNGV-së.

HARTIMI I STUDIMIT


VKDhNG e vitit 2018 në Shqipëri u bë për të matur natyrën dhe shkallën e pesë llojeve të ndryshme të DhNG-së – dhuna në familje e ushtruar nga partneri intim, dhuna gjatë marrëdhënies dashurore, dhuna nga jopartneri, ngacmimi seksual dhe, përndjekja dhe disa norma shoqërore të lidhura me DhNG-në. Studimi përfshiu një vrojtim kombëtar të familjeve me bazë popullatën të kryer në secilën nga 12 prefekturat e Shqipërisë. U përdor modeli i kampionit me shtresëzim për përzgjedhjen e grave të kampioneve. Qëllimi ishte të nxirrej një kampioni grash të moshës 18-74 vjeç, i cili do të bënte të mundur nxjerrjen e vlerësimeve të besueshme kombëtare statistikore për përhapjen e DhNG-së.

Kampioni i grave

Kampioni përfundimtar i grave përfshiu 3443 familje dhe gra të moshës 18-74 vjeç. Kampioni nuk u shpërnda në mënyrë të barabartë nëpër prefektura, pasi më shumë gra u intervistuan

në Tiranë (27,1%), kryeqyteti i vendit, i cili ka një popullsi shumë më të madhe, dhe në Fier (11,5%) dhe Elbasan (10,6%), krahasuar me Kukësin (3,0 %) dhe Gjirokastrën (2,6%) ku janë intervistuar shumë më pak gra. Pati një shpërndarje tërësisht të barabartë të grave të intervistuar në secilën nga grupmoshat. Gratë varjonin nga moshja 18 deri në 74 vjeç, me një moshë mesatare 43,6 vjeç. Sa i përket arsimit, 42,4% e grave kishin arsim të mesëm të ulët (8-9 vjet), 27,8% kishin arsim të mesëm të lartë, dhe 19,7% kishin arsim universitar; vetëm 7,7% e grave kishin vetëm arsim fillor ose më pak.

Shumica e grave të intervistuar ishin aktualisht të martuara dhe/ose jetonin me një partner mashkull (73,3%); 20,3% aktualisht nuk ishin të martuara ose nuk jetonin me një partner mashkull. Vetëm 4,1% ishin të veja, 1,2% të divorcuara dhe 0,2% të ndara nga bashkëshorti/i dashuri i tyre aktual. Shumica e grave ishin martuar ose kishin jetuar për herë të parë me një burrë në moshën 18-24 vjeçare (63,2%).



KRAHASIME TË TË DHËNAVE TË DHNG-së NDËRMJET VENDEVE ANËTARE TË BE-së DHE SHQIPËRISË

Janë bërë përpjekje për të krahasuar përhapjen e DhNG-së në Shqipëri me DhNG-në në vendet anëtare të Bashkimit Evropian bazuar në gjetjet nga vrojtimi për dhunën ndaj grave në të gjithë BE-në i realizuar në vitin 2014 nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (në vijim referuar si Vrojtimi i vitit 2014 i ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në).

NJOHJA E DALLIMEVE MES VENDEVE

Shpesh ka dallime të mëdha ndërmjet vendeve në nivelet e viktimizimit të deklaruar kur njerëzit intervistohen për një vrojtim të viktimizimit. Kjo vlen për krimin në përgjithësi, dhe veçanërisht për incidentet e DhNG-së, të cilat janë tema veçanërisht të ndjeshme për t'u folur në një vrojtim.² Ndryshimet në shkallët e përhapjes së DhNG-së ndërmjet Shqipërisë dhe 28 vendeve anëtare të BE-së, sikurse tregohet nga VKDhNG e vitit 2018 në Shqipëri dhe Vrojtimi i vitit 2014 i ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në, duhet të shihen dhe konsiderohen në marrëdhënie me një sërë faktorësh.

Megjithatë janë të pritshme ndryshimet në rezultatet e vrojtimit ndërmjet vendeve lidhur me shkallën e përhapjes së DhNG-së, njësoj si me gjetjet e vrojtimit tjerë, të tilla si studimi i dhjetë vendeve prej Organizatës Botërore të Shëndetësisë mbi shëndetin e grave dhe dhunën në familje (të dhënat e mbledhura në periudhën 2000-2003). Është

e vështirë, ndonjëherë, që të shpjegohen dhe të përgjithësohen këto ndryshime ndërmjet Shqipërisë dhe 28 vendeve anëtare të BE-së që morën pjesë në Vrojtimin e vitit 2014 të ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në.³ Arsyeja kryesore është se VKDhNG e vitit 2018 në Shqipëri nuk përdori të njëjtat instrumente të mbledhjes së të dhënave ose të njëjtën metodologji si Vrojtimi i vitit 2014 i ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në; ndonëse kishte disa ngjashmëri. Për shembull, vrojtimit në Shqipëri dhe në secilin prej vendeve anëtare të BE-së u mbështetën në përzgjedhjen rastësore të kampionit të grave të moshës 18-74 vjeç të popullatës së përgjithshme, ndonëse ndryshonin metodat e përzgjedhjes së kampionit në VKDhNG-në e vitit 2018 dhe në Vrojtimin e vitit 2014 të ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në. Ndryshime dhe ngjashmëri të tjera do të trajtohen në seksionet pasardhëse ku paraqiten krahasimet e të dhënave për DhNG-në.

Ndonjëherë ka shpjegime të tjera të mundshme të ndryshimeve të vërejtura në shkallën e përhapjes së DhNG-së mes vendeve.⁴

- Në vende të ndryshme mund të jetë më pak apo më shumë e pranueshme nga shoqëria të flitet me njerëz të tjerë lidhur më përjetimin e DhNG-së. Kur shihen rezultatet e vrojtimit, duhet të kihet parasysh mundësia se në shoqëritë ku dhuna e ushtruar nga partneri intim,

2. *Dhuna ndaj grave: Vrojtim në të gjithë BE-në: Rezultatet në një vështrim të shpejtë, 2014, f. 16.* Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore.

3. *Dhuna ndaj grave: Vrojtim në të gjithë BE-në: Rezultatet në një vështrim të shpejtë, 2014, f. 16.* Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore.

4. *Dhuna ndaj grave: Vrojtim në të gjithë BE-në: Rezultatet në një vështrim të shpejtë, 2014, f. 16.* Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore.

dhuna në familje dhe dhuna seksuale konsiderohen më së shumti çështje personale, incidentet e DhNG-së nuk u thuhën familjarëve dhe miqve dhe rrallëherë denoncohen në polici. Këto norma shoqërore mund të pengojnë komunikimin me intervistuesin e vrojtimit lidhur me përjetimin e DhNG-së.

- Barazia gjinore mund të çojë në nivele më të larta të deklaramit të DhNG-së. Incidentet e DhNG-së kanë më shumë mundësi të trajtohen haptazi dhe të kundërshtohen në shoqëritë me barazi më të madhe gjinore.
- Ekspozimi i grave ndaj faktorëve të rrezikut të dhunës mund të shqyrtohet në nivel vendi në drejtim të faktorëve që mund të rrisin ekspozimin e grave dhe vajzave ndaj dhunës. Këto përfshijnë modelet e punësimit (puna jashtë shtëpisë), socializimin dhe modelet e stilit të jetës (p.sh. takimet dashurore).
- Ndryshimet ndërmjet vendeve në të gjitha nivelet e krimit të dhunshëm duhet të merren në konsideratë krahas gjetjeve mbi DhNG-në. Për shembull, shtimi i urbanizimit në vend lidhet përgjithësisht me shtimin e nivelit të kriminalitetit.

KRAHASIME TË DHUNËS SË USHTRUAR NGA PARTNERI INTIM NDËRMJET SHQIPËRISË DHE VENDEVE ANËTARE TË BE-SË

VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri mati dhunën në familje të ushtruar nga partneri intim mes grave të moshës 18-74 vjeç që ishin/ kishin qenë aktualisht/ndonjëherë të martuara dhe/ose jetonin me bashkëshortin/partnerin. Këtyre grave iu bënë disa pyetje lidhur me përvojën e tyre me dhunën në familje të ushtruar nga partneri intim, bashkëshorti/partneri aktual dhe/ose i fundit. Tabela 1 tregon se afro 1 në 2 ose 47,0% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” dhe 1 në 3 ose 33,7% kanë përjetuar “aktualisht” një ose më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim renditur në tabelën 1. Më konkretisht, 21,0% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” dhe 8,2% “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, prej bashkëshortit/partnerit aktual dhe/ose të fundit.

Për sa i përket përjetimit gjatë jetës të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim, 41,2% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” sjellje kontrolluese shtrënguese, 31,4% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë psikologjike, 18,0% kanë

Tabela 1. Përvoja e dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim në Shqipëri (të dhëna të ponderuara)

	Ndonjëherë	Aktualisht
Kanë përjetuar dhunë në familje të ushtruar nga partneri intim (një ose disa prej 5 llojeve)	47.0%	33.7%
Sjellje kontrolluese shtrënguese	41.2%	25.2%
Dhunë ekonomike	7.0%	7.0%
Dhunë psikologjike	31.4%	19.7%
Dhunë fizike	18.0%	7.2%
Dhunë seksuale	8.6%	3.6%
Dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja	21.0%	8.2%

Shënim: Përqindja nuk arrin totalin 100% pasi të intervistuarat mund të kenë përjetuar më shumë se një lloj dhune.

përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike, 8,6% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë seksuale, dhe 7,0% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë ekonomike. Mes grave të cilat kanë përjetuar dhunë në familje të ushtruar nga partneri intim në 12 muajt përpara intervistës, 1 në 4 ose 25,2% kanë përjetuar “aktualisht” sjellje kontrolluese shtrënguese, 19,7% kanë përjetuar “aktualisht” dhunë psikologjike, 7,2% kanë përjetuar “aktualisht” dhunë fizike, 7,0% kanë përjetuar “aktualisht” dhunë ekonomike, dhe 3,6% kanë përjetuar “aktualisht” dhunë seksuale.

Tabela 2 dhe 3 krahasojnë raportin e grave që “ndonjëherë” dhe “aktualisht” kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partnerët aktualë dhe/ose të mëparshëm në Shqipëri me 28 vendet anëtare të BE-së. Ka ndryshime të rëndësishme ndërmjet VKDhNG-së së vitit 2018 në Shqipëri dhe Vrojtimit të vitit 2014 të ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në të cilat mund të bëjnë një shpjegim të mundshëm të ndryshimeve në shkallën e përhapjes të dhunës së ushtruar nga partneri intim ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së. Në veçanti, VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri mati 11 lloje të ndryshme të dhunës fizike dhe tri lloje të ndryshme të dhunës seksuale; ndërsa Vrojtimi i vitit 2014 i ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në mati nëntë lloje të ndryshme të dhunës fizike dhe katër lloje të ndryshme të dhunës seksuale. Disa, por jo të gjitha llojet e ndryshme të dhunës fizike dhe seksuale të matura ishin të njëjta. Këto ndryshime mund të ndikojnë në ndryshimin e përqindjes së grave që “ndonjëherë” dhe “aktualisht” kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partnerët aktualë dhe/ose të mëparshëm. Gjithashtu, VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri u përqendrua në gratë të cilat janë/kanë qenë aktualisht/ndonjëherë të martuara dhe/ose bashkëjetojnë me bashkëshortë/partnerë, ndërsa Vrojtimi i vitit 2014 i ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në është përqendruar në partnerët aktualë dhe/ose të mëparshëm, pavarësisht nëse gratë ishin të martuara dhe/ose jetonin me ta.

Tabela 2. Gratë që ndonjëherë kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partnerët aktualë dhe/ose të mëparshëm në Shqipëri dhe vendet anëtare të BE-së

Vendet	%
Letoni	32
Danimarkë	32
Finlandë	30
Mbretëri e Bashkuar	29
Suedi	28
Francë	26
Holandë	25
Rumani	24
Lituani	24
Belgjikë	24
Bullgari	23
Slovaki	23
Gjermani	22
Luksemburg	22
Shqipëri (2018)	21.0
Republika Çeke	21
Hungari	21
Estoni	20
Itali	19
Greqi	19
Portugali	19
Qipro	15
Irlandë	15
Maltë	15
Poloni	13
Austri	13
Kroaci	13
Spanjë	13
Sloveni	13
Mesatarja për 28 vendet të BE-së	22

Tabela 3. Gratë që aktualisht kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partnerët aktualë/të mëparshëm në Shqipëri dhe vendet anëtare të BE-së

Vendet	%
Shqipëri (2018)	8,2
Belgjikë	6
Bullgari	6
Greqi	6
Hungari	6
Itali	6
Rumani	6
Sllovaki	6
Mbretëri e Bashkuar	5
Suedi	5
Francë	5
Portugali	5
Holandë	5
Letoni	5
Finlandë	5
Republika Çeke	4
Danimarkë	4
Lituani	4
Maltë	4
Luksemburg	3
Irlandë	3
Kroaci	3
Gjermani	3
Qipro	3
Austri	3
Estoni	2
Spanjë	2
Poloni	2
Slloveni	2
Mesatarja për 28 vendet të BE-së	4

Tabela 2 tregon se 21,0% e grave të moshës 18-74 vjeç që janë aktualisht/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose jetonin me bashkëshortin/partnerin kanë deklaruar të kenë përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike dhe/ose seksuale në familje të ushtruar nga partneri intim, çka është më pak se shkalla e përhapjes së deklaruar në shumë vende anëtare të BE-së, por më shumë sesa në vende të tjera anëtare të BE-së. Shkalla e përhapjes në Shqipëri është 1,0% më e ulët se mesatarja/vlera e mesme për 28 vendet e BE-së (22,0%). Bie në sy tabela 3 që tregon se gratë në Shqipëri kishin më shumë gjasa të deklaronin se po përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partnerët aktualë/të mëparshëm në 8,2%, krahasuar me gratë në vendet anëtare të BE-së. Në fakt, përhapja prej 8,2% është dy herë më e lartë sesa mesatarja/vlera e mesme për 28 vendet e BE-së (4,0%).

KRAHASIME TË DHUNËS NGA JOPARTNERI NDËRMJET SHQIPËRISË DHE VENDEVE ANËTARE TË BE-SË

Ka prova të mjaftueshme për të provuar se gratë dhe vajzat janë në rrezik nga dhuna fizike dhe/ose seksuale nga jopartnerët në kontekstin familjar dhe në shtëpi, si dhe në hapësirat publike. Kjo VKDhNG e vitit 2018 në Shqipëri dhe Vrojtimi i vitit 2014 i ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në u përqendruan si në dhunën fizike, ashtu edhe në atë seksuale nga jopartneri të përjetuar nga gratë që nga moshë 15 vjeçare prej familjarëve dhe të afërmeve të tjerë, ashtu edhe prej jofamiljarëve.

VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri mati përjetimin e dhunës nga jopartneri mes grave të moshës 18-74 vjeçare. Këtyre grave iu bënë disa pyetje rreth përvojës së tyre me dhunën fizike dhe seksuale të ushtruar nga jopartneri. Tabela 4 tregon se mes grave të moshës 18-74 vjeç, 18,2% “ndonjëherë” dhe 2,4% “aktualisht” kanë përjetuar një ose më shumë nga katër llojet e dhunës fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri që nga moshë 15 vjeçare nga dikush që nuk ka qenë bashkëshorti/partneri i tyre.

Gratë kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë fizike nga jopartneri (17,3% ndonjëherë, 2,3% aktualisht) sesa dhunë seksuale nga jopartneri (1,3% ndonjëherë, 0,1% aktualisht).

Tabela 4. Përvojat e dhunës nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare, në Shqipëri (të dhëna të ponderuara)

	Gra të moshës 18-74 vjeç N=1,040,726	
	Ndonjëherë	Aktualisht
Kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri që nga moshja 15 vjeçare	18.2%	2.3%
Kanë përjetuar dhunë fizike nga jopartneri që nga moshja 15 vjeçare	17.3%	2.3%
Kanë përjetuar dhunë seksuale nga jopartneri që nga moshja 15 vjeçare	1.3%	0.0%

Tabela 5 krahason raportin grave që “aktualisht” kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartnerët që nga moshja 15 vjeçare në Shqipëri me 28 vendet anëtare të BE-së. Ka ndryshime të rëndësishme ndërmjet VKDhNG-së së vitit 2018 në Shqipëri dhe Vrojtimit të vitit 2014 të ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në të cilat mund të bëjnë një shpjegim të mundshëm të ndryshimeve në shkallën e përhapjes të dhunës së ushtruar nga jopartneri ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së. Në veçanti VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri mati një lloj të dhunës fizike dhe tri lloje të ndryshme të dhunës seksuale; ndërsa Vrojtimi i vitit 2014 i ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në mati nëntë lloje të ndryshme të dhunës fizike dhe katër lloje të ndryshme të dhunës seksuale. Këto ndryshime mund të ndikojnë në ndryshimin e përqindjes së grave

që kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartnerët që nga moshja 15 vjeç.

Tabela 5 tregon se 18,0% e grave të moshës 18-74 vjeç “aktualisht” kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartnerët, çka është më pak se shkalla e përhapjes së deklaruar në shumë vende anëtare të BE-së, por më shumë sesa në vende të tjera anëtare të BE-së. Shkalla e përhapjes në Shqipëri është 4,0% më e ulët se mesatarja/vlera e mesme për 28 vendet e BE-së (22,0%).

KRAHASIME TË NGACIMIT SEKSUAL NDËRMJET SHQIPËRISË DHE VENDEVE ANËTARE TË BE-SË

Ngacmim seksual do të thotë përpjekje të pa mirëpritura seksuale, kërkesa për favore seksuale dhe ngacmime të tjera verbale apo fizike me natyrë seksuale, që përbëjnë shkelje të parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave; prandaj ai është një formë abuzimi seksual, diskriminimi seksual dhe DhNG. Studimi aktual ka treguar se gratë ndryshojnë në perceptimin e sjelljes që përbën ngacmim seksual dhe këto nocione të asaj që përbën “ngacmim seksual” mund të ndryshojnë ndjeshëm nga vendi në vend; prandaj vlerësimi i shtrirjes së ngacmimit seksual bazohet në përvojën personale të grave dhe të përgjigjes subjektive që të intervistuarat i japin sjelljes që mund të konsiderohet e padëshiruar dhe ofenduese.⁵⁶ Për të ulur në minimum ndryshimet kulturore në interpretimin subjektiv të ngacmimit seksual, të intervistuarat u pyetën nëse kishin përjetuar veprime specifike të padëshiruara dhe ofenduese. Megjithatë, ende mund të ketë ndryshime në shkallën që grave, në kontekste kulturore të ndryshme, veprimet e përshkruara t’u duken ofenduese ose të sikletshme.⁷

5. Komisioni Evropian (1998), Ngacmimi seksual në vendin e punës në Bashkimin Evropian, Bruksel, Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Punësimin, Marrëdhëniet e Punës dhe Çështjet Sociale
6. Dhuna ndaj grave: Vrojtim në të gjithë BE-në, 2014, f. 96-97.
7. Dhuna ndaj grave: Vrojtim në të gjithë BE-në, 2014, f. 96-97.

Tabela 5. Gratë që kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartnerët që nga moshën 15 vjeçare në Shqipëri dhe vendet anëtare të BE-së

Vendet	%
Danimarkë	40
Holandë	35
Suedi	34
Finlandë	33
Francë	33
Mbretëri e Bashkuar	30
Luksemburg	25
Belgjikë	25
Gjermani	24
Slovaki	22
Estoni	22
Republika Çeke	21
Irlandë	19
Shqipëri (2018)	18
Letoni	17
Itali	17
Spanjë	16
Lituani	16
Maltë	15
Sloveni	15
Rumani	14
Hungari	14
Bullgari	14
Kroaci	13
Austri	12
Qipro	12
Poloni	11
Portugali	10
Greqi	10
Mesatarja për 28 vendet të BE-së	22

VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri bëri pyetje grave lidhur me gjashtë veprime specifike të ngacmimit seksual që grave u janë dukur të padëshiruara dhe që i kanë përjetuar si ofenduese dhe/ose të sikletshme. Gjashtë pyetjet trajtonin katër forma të mundshme të ngacmimit seksual që ishin të padëshiruara dhe ofenduese sipas të intervistuarave:

- Format fizike të ngacmimit – prekje, përqafim ose puthje jo të mirëpritura.
- Format verbale të ngacmimit – komente ose shaka me sugjerime seksuale, ofenduese; pyetje të bezdisshme, ofenduese rreth jetës private; komente të bezdisshme, ofenduese rreth pamjes fizike të një gruaje.
- Format joverbale të ngacmimit – marrja ose tregimi i pikturave, fotografive ose dhuratave të qarta seksuale; dikush kishte treguar në mënyrë të turpshme pjesët private.
- Ngacmimi kibernetik – marrja e emailëve apo mesazheve me tekst ofenduese apo të padëshiruara seksuale të shprehura; orvatje të papërshtatshme ofenduese në faqe të rrjeteve sociale ose në dhomat e bisedës në internet.

VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri konstatoi se 18,1% e grave të moshës 18-74 vjeç “ndonjëherë” dhe 8,5% “aktualisht” kanë përjetuar një ose më shumë nga gjashtë llojet e ngacmimit seksual të matur.

Tabela 6 krahason raportin e grave që “aktualisht” kanë përjetuar ngacmim seksual që nga moshën 15 vjeçare në Shqipëri me 28 vendet anëtare të BE-së. Ekzistojnë ndryshime të rëndësishme ndërmjet VKDhNG-së së vitit 2018 në Shqipëri dhe Vrojtimit të vitit 2014 të ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në që mund të shpjegojnë ndryshimet e vërejtura në shkallën e përhapjes së ngacmimit seksual ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së. Që të dy, VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri dhe Vrojtimi i vitit 2014 i ATDh-së për

DhNG-në në të gjithë BE-në matën gjashtë lloje të ndryshme të ngacmimit seksual; megjithatë, vetëm katër nga gjashtë llojet e ngacmimit seksual ishin të njëjta dhe dy ishin të ndryshme. Këto ndryshime mund të ndikojnë në ndryshimin e përqindjes së grave që aktualisht kanë përjetuar ngacmim seksual që nga moshja 15 vjeçare.

Tabela 6 tregon se vetëm 9,0% e grave “aktualisht” kanë përjetuar ngacmim seksual, çka është më pak se shkalla e përhapjes së deklaruar në shumicën e vendeve anëtare të BE-së. Shkalla e përhapjes në Shqipëri është 4,0% më e ulët se mesatarja/vlera e mesme për 28 vendet e BE-së (13,0%).

KRAHASIME TË PËRVOJËS SË GRAVE ME PËRNDJËKJEN NDËRMJET SHQIPËRISË DHE VENDEVE ANËTARE TË BE-SË

Përndjekja i referohet sjelljes ngacmuese ose kërcënuese në të cilën një individ përfshihet në mënyrë të përsëritur, si ndjekja e një personi, vajtja në shtëpinë ose në punën e personit, bërja e telefonatave ngacmuese, lënia e mesazheve ose objekteve të shkruara ose vandalizimi i pronës së personit. Këto veprime mund të ndiqen nga një kërcënim i besueshëm për lëndime serioze dhe mund të jenë paraprirës të një sulmi ose vrasjeje. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e përkufizon përndjekjen si “përsëritjen e veprimeve për të hyrë me forcë në jetën e personit, të cilat me kohë shtojnë intensitetin. Përfundimisht, përndjekja shkakton shqetësim, ankth dhe/ose frikë. Është një formë dhune në vetvete, por mund të shkaktojë forma të tjera të dhunës, duke përfshirë vrasjen.”

Në përgjithësi, sjellja përndjekëse mund të përfshijë modele të vazhdueshme të lënies apo dërgimit të artikujve apo dhuratave të padëshiruara viktimës, të cilat mund të jenë në dukje romantike deri në të çuditshme, ndjekjen pas apo qëndrimet në pritje të

Tabela 6. Gratë që aktualisht kanë përjetuar ngacmim seksual që nga moshja 15 vjeçare në Shqipëri dhe vendet anëtare të BE-së

Vendet	%
Danimarkë	26
Holandë	22
Suedi	22
Slovaki	19
Francë	18
Belgjikë	17
Mbretëri e Bashkuar	16
Finlandë	15
Cjermani	15
Luksemburg	14
Itali	10
Republika Çeke	12
Irlandë	12
Spanjë	11
Maltë	12
Hungari	12
Austri	11
Kroaci	11
Estoni	11
Greqi	9
Letoni	9
Bullgari	9
Lituani	9
Shqipëri	9
Qipro	8
Portugali	8
Sloveni	7
Poloni	7
Rumani	5
Mesatarja për 28 vendet të BE-së	13

Gjetjet treguan se 12,6% e grave kanë përjetuar një ose më shumë nga gjashtë llojet e përndjekjes së matur dhe 6,9% kanë përjetuar përndjekje gjatë 12 muajve përpara vrojtitimit

viktimës, dëmtimin apo kërcënimin për dëmtim të pronës së viktimës, përgojimin e karakterit të viktimës, apo ngacmimin e viktimës përmes internetit duke postuar informacion personal rreth saj, apo përhapjes së thashethemeve për viktimën. Përndjekja shpesh përfshin veprime që të veçuara janë të padëmshme, por të ndërthurura synojnë të kërcënojnë ndjenjën e sigurisë së viktimës. Përndjekja shumë shpesh shkaktohet prej personave të njohur prej viktimës ose me të cilët viktima ka pasur një marrëdhënie të mëparshme (p.sh. partner intim i mëparshëm/aktual ose një i njohur); megjithatë, disa gra përndiqen nga të panjohur.

Përndjekja mund të kryhet prej vetë personit ose nëpërmjet mekanizmave elektronike. Në fakt, përndjekja kibernetike përfshin ndjekjen, ngacmimin ose kontaktimin e të tjerëve pa e kërkuar ata fillimisht nëpërmjet internetit dhe/ose emailit. Përndjekja kibernetike mund të intensifikohet në dhomat e bisedave ku përndjekësit e mbushin sistematikisht inboksen e shënjestrave të tyre me mesazhe dhe imazhe të pahijshme, urryese dhe/ose kërcënuese. Përndjekësit kibernetikë mund edhe të marrin identitetin e viktimës duke postuar informacion (të rremë ose jo) dhe duke kërkuar përgjigje nga komuniteti kibernetik. Përndjekësit kibernetikë mund ta përdorin informacionin e marrë online për ta

frikësuar, ngacmuar dhe kërcënuar më shumë viktimën. Ndonëse përndjekja kibernetike nuk përfshin kontaktin fizik me viktimën, mbetet krim i rëndë.

Konventa e Stambollit e Këshillit të Evropës u bën thirrje palëve të Konventës që të kriminalizojnë sjelljen e qëllimshme për t'u përfshirë në mënyrë të përsëritur në sjellje kërcënuese të drejtuara ndaj një tjetër personi, duke i shkakuar viktimës frikë për sigurinë e vet. Kodi Penal i Shqipërisë ka një nen për përndjekjen "Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkakuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës" (Neni 121/a).

VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri u përqendrua në matjen e gjashtë llojeve të ndryshme të përndjekjes së përjetuar nga gratë, pa përdorur termin "përndjekje". Gjetjet treguan se 12,6% e grave kanë përjetuar një ose më shumë nga gjashtë llojet e përndjekjes së matur dhe 6,9% kanë përjetuar përndjekje gjatë 12 muajve përpara vrojtitimit. Vetëm 35,6% e grave që kanë përjetuar përndjekje i konsideronin kontaktet e padëshiruara ose sjelljet ngacmuese si përndjekje.

Tabela 7 krahason raportin e grave që “aktualisht” kanë përjetuar përndjekje në Shqipëri me 28 vendet anëtare të BE-së. Ekzistojnë ndryshime të rëndësishme ndërmjet VKDhNG-së së vitit 2018 në Shqipëri dhe Vrojtimit të vitit 2014 të ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në që mund të shpjegojnë ndryshimet e vërejtura në shkallën e përhapjes së përndjekjes ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së. VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri mati gjashtë lloje të ndryshme të ngacmimit seksual, ndërsa Vrojtimi i vitit 2014 i ATDh-së për DhNG-në në të gjithë BE-në mati tetë lloje të ndryshme të përndjekjes; kishte mbivendosje të llojeve të përndjekjes të matura. Këto ndryshime mund të ndikojnë në ndryshimin e përqindjes së grave që aktualisht kanë përjetuar përndjekje.

Tabela 7 tregon se vetëm 7,0% e grave në Shqipëri “aktualisht” kanë përjetuar përndjekje, çka është më pak se shkalla e përhapjes së deklaruar në vetëm pak vende të BE-së. Shumica e vendeve anëtare të BE-së kishin shkallë të përhapjes më të ulëta sesa Shqipëria. Shkalla e përhapjes në Shqipëri (7,0%) ishte pakëz më e lartë sesa mesatarja/ vlera e mesme për 28 vendet e BE-së (5,0%).

VROJTIMI I ORGANIZATËS PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË MBI MIRËQENIEN DHE SIGURINË E GRAVE

Në vitin 2018, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) udhëhoqi një vrojtim mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave, i cili u zbatua në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Moldavi dhe Ukrainë. Qëllimi i vrojtimit të udhëhequr nga OSBE ishte të siguronte të dhëna të krahasueshme për format e ndryshme të dhunës që gratë përjetojnë në fëmijëri dhe gjatë gjithë jetës së tyre. Studimi mori në shqyrtim dhunën që gratë përjetojnë në mjediset e konfliktit dhe jokonfliktit, si dhe ndikimin që dhuna ka te gratë. Pyetjet në lidhje me normat shoqërore

Tabela 7. Përqindja e grave që aktualisht kanë përjetuar përndjekje sipas vendeve anëtare të BE-së (2014) dhe Shqipërisë (2018)

Vendet	%
Suedi	9
Francë	8
Luksemburg	7
Shqipëri	7
Belgjikë	6
Maltë	6
Holandë	6
Slovaki	6
Austri	6
Danimarkë	5
Mbretëri e Bashkuar	5
Itali	5
Hungari	5
Gjermani	4
Letoni	4
Finlandë	4
Bullgari	4
Kroaci	3
Irlandë	3
Spanjë	3
Qipro	3
Sllloveni	3
Portugali	3
Poloni	3
Greqi	2
Republika Çeke	2
Rumani	2
Estoni	1
Lituani	0
Mesatarja për 28 vendet të BE-së	5

dhe qëndrimet për DhNG-në u përfshinë për të kuptuar më mirë shkaqet themelore të dhunës. Vrojtimi i udhëhequr nga OSBE-ja përdori një metodologji ndryshe dhe mjete të ndryshme për mbledhjen e të dhënave nga VKDhF dhe u ndërmor me qëllim sigurimin e të dhënave specifike për vendin, por të krahasueshme për forma të ndryshme të dhunës që gratë përjetojnë në fëmijërinë e tyre dhe gjatë gjithë jetës së tyre. Studimi shqyrtoi gjithashtu ndikimin që ka dhuna te gratë, përfshirë pasojat e saj të gjata, si dhe normat dhe qëndrimet e lidhura me dhunën ndaj grave për të kuptuar më mirë shkaqet themelore të dhunës.

Gjetjet nga vrojtimi i udhëhequr nga OSBE-ja për mirëqenien dhe sigurinë e grave u krahasuan me VKDhNG-në e vitit 2018 në Shqipëri. Siç u përmend më herët VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri ka matur dhunën në familje të ushtruar nga partneri intim mes grave të moshës 18-74 vjeç që janë aktualisht/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose jetonin me bashkëshortin/partnerin dhe gjeti se 47,0% e grave “ndonjëherë” dhe 33,7% “aktualisht” kanë përjetuar një ose më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim (d.m.th., sjellje kontrolluese, dhunë psikologjike, dhunë ekonomike, dhunë fizike dhe dhunë seksuale). Më konkretisht, 21,0% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” dhe 8,2% “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, prej bashkëshortit/partnerit aktual dhe/ose të fundit.

Për krahasim, studimi i vitit 2018 i udhëhequr nga OSBE-ja në Shqipëri zbuloi se 19,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar dhunë të ushtruar nga partneri intim që nga moshja 15 vjeçare dhe 19,0% kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale që nga moshja 15 vjeçare. Gjatë 12 muajve para vrojtimit të udhëhequr prej OSBE-së, 7,2% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar dhunë

Studimi i vitit 2018 i udhëhequr nga OSBE-ja në Shqipëri zbuloi se 19,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar dhunë të ushtruar nga partneri intim që nga moshja 15 vjeçare dhe 19,0% kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale që nga moshja 15 vjeçare.

fizike dhe/ose seksuale të ushtruar nga partneri intim. Gjetjet nga këto dy studime ofrojnë vlerësime për përqindjen e grave që përjetojnë dhunë në marrëdhëniet e tyre intime. Është e rëndësishme të kuptohet që në varësi të kampionit, duke përfshirë moshat e grave të përfshira në kampion, përhapja e dhunës së ushtruar nga partneri intim mund të ndryshojë, dhe matje të ndryshme të dhunës nga partneri intim mund të rezultojnë në nivele të ndryshme të përhapjes.

VKDhNG-ja e vitit 2018 zbuloi gjithashtu se mes të gjitha grave të moshës 18-74 vjeç, 18,2% “ndonjëherë” kanë përjetuar dhunë nga jopartneri që nga moshja 15 vjeçare, prej të cilave 17,3% kanë përjetuar dhunë fizike nga jopartneri dhe 1,3% kanë përjetuar dhunë seksuale nga jopartneri gjatë jetës së tyre; 3,4% e grave kanë përjetuar dhunë nga jopartneri gjatë 12 muajve përpara vrojtimit. Vetëm 4,6%

e grave kanë kërkuar ndihmë për dhunën nga jopartneri. Për krahasim, studimi i vitit 2018 nën udhëheqjen e OSBE-së në Shqipëri zbuloi se 11,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar dhunë nga jopartneri që nga mosha 15 vjeçare, prej të cilave 11,0% e grave kanë përjetuar dhunë fizike nga jopartneri dhe 1,0% kanë përjetuar dhunë seksuale nga jopartneri. Të dhënat nga këto dy studime zbulojnë se asnjëri prej studimeve nuk prodhon të njëjtat shkallë të përhapjes, por që dy na bëjnë të kuptojmë se 11,0% deri në 18,0% e grave në Shqipëri kanë përjetuar dhunë nga jopartneri që nga mosha 15 vjeçare.

Së fundi, edhe VKDhNG-ja e vitit 2018 zbuloi gjithashtu se 18,1% “ndonjëherë” kanë përjetuar ngacmim seksual dhe 8,5% kanë përjetuar ngacmim seksual gjatë 12 muajve përpara vrojtimit. Për më tepër, 12,6% “ndonjëherë” kanë përjetuar përndjekje dhe 6,9% kanë përjetuar përndjekje gjatë 12 muajve përpara vrojtimit. Për krahasim, vrojtimi i vitit 2018 nën udhëheqjen e OSBE-së në Shqipëri zbuloi se 13,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar përndjekje që nga mosha 15 vjeçare dhe 4,3% kanë përjetuar përndjekje gjatë 12 muajve përpara vrojtimit, dhe 34,0% e grave kanë përjetuar ngacmim seksual që nga mosha 15 vjeçare dhe 17,2% kanë përjetuar ngacmim seksual gjatë 12 muajve përpara vrojtimit. Ndërkohë që të dyja këto studime ofrojnë vlerësime të ngjashme për përqindjen e grave që “ndonjëherë” dhe “aktualisht” kanë përjetuar përndjekje në Shqipëri, vlerësimet për përqindjen e grave që kanë përjetuar ngacmim seksual gjatë jetës shkonin nga 18,0% në 34,0%, dhe përqindja e grave që kanë përjetuar ngacmim seksual gjatë 12 muajve përpara vrojtimit shkonte nga 8,0% në 17,0%.

**Ending
Violence**
Against
Women

